DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-148/3
Data Datum Date 21.02.2022

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administacije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Abdulhadi Krasniç,** Kryetar i Komunës së Mamushës<br>**Necmedin Morina,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mamushës | |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi** , Minister i MAPL-së<br>**Venera Çerkini,Zv.** Sekretare e Përgjithshme në MAPL | |
| Nga: | **Besim Myrtezani,Zv.** Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 10.02.2022<br>VI-020-148 |
| Zyrtarët përgjegjës<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Gëzim Sahiti**,Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Leonora Bajrami**, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së Mamushës | |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01 Nr.03/2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete. |
| I miratuar më datë: 27.01.2022 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.02.2022 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës <u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| **Nr.** | **Formulimi në aktin e komunës** | **Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.** |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi 01 Nr.03/2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete. | Vendimi 01 Nr.03/2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Mamushës, i miratuar me datë 27.01.2022, është në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe me nenin 8 paragrafi 2 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, **ku sqaron se**: *"Komiteti per komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët janë përfaqësuesit e komuniteteve.*<br>*Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete, i cili komitet duhet të reflektoj barazinë gjinore në pajtim më legjislacionin në fuqi.*<br>*Perberja e komitetit per komunitete duhet te jete tek.*<br>*Emërtimi i komuniteteve të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.* |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-148/3
Data. Datum. Date. 11.02.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Abdulhadi Krasniç**, gradonačelnik opštine Mamuša<br>**Necmedin Morina**, predsedavjući Skupštine opštine Mamuša | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elbert Krasniqi**, ministar MALS-a,<br>**Venera Çerkini**, zamenica generalnog sekretara MALS-a, | |
| Od: | **Besim Murtezani**, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS | Dana, 10.02.2022.<br>br: VI-020-148 |
| Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:<br><br>Službenik-ca za izradu pravne procene: | **Gëzim Sahiti**, zamenik rukovodioca Odseka za monitorisanje opština<br><br>**Leonora Bajrami**,, službenica za monitorisanje opština | |
| | | |
| Predmet: | Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Mamuša | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvaženi predsedavjući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.06/2021 o dopuni i izmeni Uredbe VRK-a br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, utvrđenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kao što je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 01 br.03 / 2022 o osnivanju Odbora za zajednice. |
| Usvojena dana, 27.01.2022. |
| Predložena na razmatranje u MALS-u, dana 08.02.2022. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

Neusaglašenosti opštinskog akta podnetog na razmatranje zakonitosti su sledeće:

| Br. | Formulisanje u aktu opštine | Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti. |
|---|---|---|
| | | |
| 1. | Odluka 01 br.03 / 2022 o osnivanju Odbora za zajednice. | Odluka 01 br.03/2022 o osnivanju Odbora za zajednice Skupštine opštine Mamuša, usvojena 27.01.2022, je u suprotnosti sa članom 53 stav 1 Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi kao i članom 8. stav 2. i 4. Administrativnog uputstva (MLS) br. 05/2020 o postupku osnivanja, sastava i nadležnosti stalnih i drugih Odbora u opštini, **gde se pojašnjava da:** *"Odbor za zajednice uključuje u svoje redove prostu večinu članova skupštine opštine, članovi su predstavnici zajednica. Svaku zajednicu koja živi u opštini predstavlja najmanje jedan predstavnik u odboru za zajednice, koji odbor treba da odražava rodnu ravnopravnost u skladu sa zakonodavstvom na snazi.*<br>*Nazive zajednica izvršiti po zakonodavstvu na snazi.* |

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine **traži** da preduzimaju konkretne delatnosti kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

01 Nr...05 2022
Më 27.01.2022
Mamushë

01 Nr. 05-22
27.01.2022

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 02.02.2022

| Njësia organizative | Nr i Lëndës | Vlera |
| --- | --- | --- |
| -01- | 000 148 | |

Në bazë të nenit 33 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 63 dhe 64 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008 Kuvendi i Komunës së Mamushës

**V E N D I M**
**Për themelimin e Komitetit për Komunitete**

I

Në mbledhjen e mbajtur më 27.01.2022 Kuvendi I Komunës së Mamushës ka themeluar Komitetin për Komunitet të Kuvendit Komunal të Mamushës.

II

Komiteti për Komunitete të Kuvendit Komunal të Mamushës do të përbehet nga këto anëtarë:

1.Znj.Albiona Sadiku-Kryesuesja e Komitetit **(GJINIA FEMRORE)**

2.Znj.Hatice Mazrek-Anëtare nga Komuniteti Turk **(GJINIA FEMRORE)**
3.Z.Necmedin Sala-Anëtar nga Komuniteti RAE **(GJINIA MASHKULLORE)**
4.Z.Adnan Zogaj-Anëtar nga Komuniteti Shqipar **(GJINIA MASHKULLORE)**
5.Z..Ramadan Bytyqi-Anëtar nga Komuniteti Shqiptar **(GJINIA MASHKULLORE)**
6.Z.Hasan Kryezi-Anëtar nga Komuniteti Turk **(GJINIA MASHKULLORE)**

III

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit të tij në asamble.

Me këtë vendim njoftohet:
*Zyra e Kryetarit
*MAPL
*Zyra e Personelit
*Arkivi

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

NECMEDIN MORINA